

PREFEKTURA DIBËR  
Ardhur  
Nr. 1013 dt. 06.11.23



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DIBËR  
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

Nr. 4471 Prot

Peshkopi, më 06.11.2025

**Lënda:** Dërgim vendimi

**Drejtuar:** Prefekti i Qarkut Dibër

Bashkëngjitur po ju dërgojmë për konfirmim Vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër Nr. 75

**Datë:** 03.11.2025 si dhe projekt-vendimin nr.3313/2 Datë 28.10.2025

**“Për një ndryshim në VKB nr. 59 datë 01/10/2025 për miratim fondi për ndihmë shtetërore  
financiare”**

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

**Sekretari i Këshillit Bashkiak**

Hir Elezi



Kapaja  
06.11.2025  
Duy



647/12/14/25

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT DIBËR

Nr.1013/1 prot.

Peshkopi, më 11.11.2025

**Lënda:** Për vendimin e Këshillit të Bashkisë Dibër.

**BASHKISË**


**DIBËR**

Në mbështetje të nenit 16-të të ligjit nr.107 datë 27.10.2016, "Për Prefektin e Qarkut", të ndryshuar, pasi verifikova për efekt ligjshmërie vendimin nr. 75 (shtatëdhjetepesë) datë 03.11.2025, të Këshillit të Bashkisë Dibër, "Për akordim fondi për ndihmë shtetërore financiare", për banesë të dëmtuar nga faktorë natyrorë apo njerëzorë, **vendosa** :

Miratimin në parim të kësaj vendimmarrje në kushtet e respektimit të legjislacionit aktual në fuqi që rregullon marrëdhëniet juridike në fushën e së drejtës përkatëse.

Duke ju falenderuar për mirkuptimin.

**PREFEKTI**  
Nexhbedin **SHËHU**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DIBËR  
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

VENDIM

Nr. 75 Datë 03/11/2025

**“Për një ndryshim në VKB Nr. 59 datë 01/10/2025 për miratim fondi për ndihmë shtetërore financiare”**

Në mbështetje të ligjit nr.139.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr.107 datë 22.10.2016 “Për prefektin e Qarkut”, ligji nr.45 datë 18.07.2019 “Për mbrojtjen civile”, VKM nr.329 datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore” kreu III, pika 1, gërma ë, dhe kreu III, pika 3, gërma ç, Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës **03.11.2025**, me 19 vota pro, 0 kundër dhe 0 abstenim:

**VENDOSI:**

1. Të miratojë dokumentacionin tekniko-ligjor.
2. Të njohë vlerën totale të dëmit për objektin apartament banimi në kat të tretë në pronësi të Z.Bajram Kurti, Njësia Administrative Peshkopi në shumën totale 1,105,566.47 lekë sipas dokumentacionit të paraqitur nga ana e komisionit për këtë qëllim. Nga kjo vlerë e dëmit ndërtimore 1,105,566.47 lekë dhe vlera e dëmit orendiak 0 lekë.
3. Nga fondi i emergjencave civile të Bashkisë Dibër të trajtohet i dëmtuari në shumën prej **552.783.5** lekë (50% të vlerës totale të dëmit) për ti përdorur për riparimin e dëmit të shkaktuar.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas shprehjes për bazueshmëri ligjore nga ana e Institucionit të Prefektit të Qarkut Dibër.
5. Vendimi u shpall me datë **03.11.2025**.

Kryetar i Këshillit Bashkiak





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**RASHKIA DIBËR  
DREJTORIA PPECK**

*Nr.3313/2 prot.*

*Peshkopi, më 28.10. 2025*

**PROPOZIM PER NJE NDRYSHIM NE PROJEKT-VENDIMIN NR.3313/1 prot.  
date 11.09.2025**

**“ Për miratim fondi për ndihmë shtetërore financiare”**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 139 datë 17. 12. 2015 “ Për vetqeverisjen vendore”, Ligjit Nr. 107 datë 22. 10. 2016 “ Për Prefektin e Qarkut “, Ligjit Nr. 45 datë 18. 07. 2019 “ Për Mbrojtjen Civile”, VKM Nr. 329 datë 16. 05. 2012 “ Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore” kreu III, pika 1, gërma ë, dhe kreu III, pika 3, gërma ç, në mbledhjen e tij.

**Kerkojme :**

- I. Të miratojë dokumentacionin tekniko-ligjor.
- II. Të njohë vlerën totale të dëmit për objektin **apartament banimi ne kat te trete** në pronësi të **Z. Bajram Kurti** Njësia Administrative Peshkopi në shumën totale **1,105,566.47** lekë sipas dokumentacionit të paraqitur nga ana e komisionit për këtë qëllim. Nga kjo vlera e dëmit ndërtimor **1,105,566.47** lekë dhe vlera e dëmit orendiak **0** lekë.
- III. Nga fondi emergjencave civile të bashkisë Dibër të trajtohet i dëmtuari në shumën prej **552.783.5** lekë ( 50 % të vlerës totale të dëmit ) për ti përdorur për riparimin e dëmit të shkaktuar.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit nga Institucioni Prefektit Qarkut Dibër për bazueshmërinë ligjore.

**PËR BASHKINË DIBËR**

**DREJTORI I PPECK**

**DREJTORI EKONOMIK**

Çeljeta ZUNA

**DREJTORI I DREJTORISE JURIDIKE**

Ismet SARACI

**KRYETARI I BASHKISË**

Rahim SPAHIU



MIRATOHET  
BASHKIA DIBER

Projektuesi: ING EDVIN SHAHI

Objekti: RIKONSTRUKSION APARTAMENT

BAJRAM KURTI

Datë: 10-09-2025

## PREVENTIV

NR	KODE	EMËRTIMI I PUNIMEVE	NJËSIA	SASIA	CMIMI	VLEFIA
		<b>1. PUNIME TAVANI DHE SUVATIMI</b>				
1	2.297/b	Tavan i varur me pllaka gipsi 60x60cm	m2	36.0	3 348.97	120,562.92
2	2.358/b	Veshje fasade me polisterol t=5cm + rrjete + suva.	m2	56.0	4,688.37	262,548.72
		<b>Shuma 1:</b>				<b>383,111.64</b>
		<b>2. PUNIME HIDROIZOLIMI DHE CATITE</b>				
3	2.256/b	Mbulim catie me panele sanduic	m2	110.0	3,440.24	476,817.00
		<b>Shuma 2:</b>				<b>476,817.00</b>
		<b>3. PUNIME DYER DRITARE</b>				
4	2.386/2	Dyer te blinduara	m2	3.0	44 441.55	133,324.66
		<b>Shuma 3:</b>				<b>133,324.66</b>
		<b>4. INSTALIME HIDRO-SANITARE DHE NGROHJE</b>				
5	2.491/d	F.V. Tuba e rakorderi ujesjellesi PPR d=40mm, Pn 16	ml	42.0	535.87	22,506.37
6	2.491/2h	F.V. Tuba e rakorderi ujesjellesi PE d=110mm, t = 8.1 mm, Pn 10	ml	11.0	1,578.56	17,364.20
7	2.508	F.V. Bolier 100 l	copë	1.0	12,885.43	12,885.43
8	2.494	F.V. Saracineska bronzi Ø 1/2 " = 15 mm	copë	2.0	1,175.50	2,351.00

					Shuma 4:			55,107.00
<b>5. INSTALIME PER NDRICIM</b>								
09	2.487/b	F.V. Kuti-suport pllaket-4 mod	copë	2.0	443.71			887.42
10	2.480/2	F.V. Tub plastmasi Ø 18-21mm	ml	64.0	222.00			14,207.81
11	2.481/1	F.V. Percjelles PV-500 Ø 1.5 mm2	ml	46.0	44.55			2,049.48
12	2.481/2	F.V. Percjelles PV-500 Ø 2.5 mm2	ml	92.0	61.41			5,649.35
13	2.481/3	F.V. Percjelles PV-500 Ø 4 mm2	ml	10.0	72.24			722.39
14	2.486	F.V. Portollampa norm 10 A	copë	12.0	374.88			4,498.54
15	2.489	F.V. Siguresa ~ 25 A	copë	6.0	506.24			3,037.46
16	2.487	F.V. Kutiderivacioni plastm	copë	9.0	775.64			2,030.72
17	2.485	F.V. Çelesa e priza 10 A me nulifikim	copë	12.0	788.83			9,465.90
18	2.485/d	F.V. Priza shuko universal	copë	12.0	788.83			9,465.90
19	2.490/1e	F.V. Automat termo/el.manj. diferencial 2P 220V, 63A	copë	1.0	5,191.20			5,191.20
					Shuma 5:			57,206.17
<b>Shuma Analiza</b>								<b>1,105,566.47</b>
<b>Fondi Rezervë (5.0%)</b>								<b>0</b>
<b>Shuma Analiza + Fondi Rezervë (5.0%)</b>								<b>0</b>
<b>TVSH (20%)</b>								<b>0</b>
<b>Shuma me TVSH</b>								<b>0</b>
<b>Totali</b>								<b>1,105,566.47</b>

Preventivuesi:

Ing Edvin Shaha

Shënime:

ESHTE PERDORUR SISTEMI I INTEGRUAR I CMIMEVE SIPAS MANUALIT AKTUAL TE VITIT 2023.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA DIBER  
DREJTORIA PPECK**

**Lënda :** Relacion shpjegues në lidhje me propozimin për një ndryshim në Projekt Vendimin me nr.3313/1 prot.datë 11.09.2025 “Për miratim fondi për ndihmë shtetërore financiare”.

KËSHILLIT BASHKIAK DIBËR

Bazuar në ligjin 139/2015 “ Për Vetqeverisjen Vendore”, ligjin 45/2019 “ Për Mbrojtjen Civile”, VKM nr. 329/2012 “ Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësia natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, **për zjarrin e rënë si dhe djegies së banesës në pronësi të qytetarit Bajram Kurti**, Njësia Administrative Peshkopi, ju sqarojmë se është verifikuar rasti nga Komisioni i ngritur me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë Dibër, janë bërë kqyrja e objektit si dhe veprimet që me matjet, fotografimet e objektit brenda e jashtë si dhe gjithë dëmtimet në banesë, duke bërë dhe vlerësimet e dëmeve në përputhshmëri me kërkesat e zbatimit sipas **V.K.M-se nr. 216 datë 13.04.2023,** “ Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim” si dhe listës së çmimeve të orendive e pajisjeve elektroshtëpiake të sjella nga Institucioni Prefektit të Qarkut Dibër me nr. 20/1 datë 11. 01. 2022, protokolluar në bashki me nr. 24/1 datë 13. 01. 2022 dhe ka si dokument shoqërues shkresën e sjellë nga Ministria Brendshme me nr. 565/8 datë 12. 05. 2016 “ Çmimet aktuale mesatare të mobiljeve, orendive dhe pajisjeve elektroshtëpiake të dërguara nga Drejtoria Përgjithshme e tatimeve” . Dokumentacioni tekniko – ligjor është bashkëlidhur në dosje bazuar në VKM nr. 329/2012 datë 16.05.2021 “ Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësia natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”.

Në ndryshimin e vendimit nr.59 datë 01.10.2025 ju bëjmë me dije se nga Institucioni i Prefekturës i kthyer me shkresën 888/1 datë 13.10.2025 për rishqyrtim Bashkisë Dibër që “Masa e ndihmës financiare është 50% e vlerës së dëmit pa përfshirë vlerat e shtuara nga fondi i veçantë dhe TVSH pasi subjekti përfitues nuk është tatim pagues si deklarues TVSH-je.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

DREJTORI I PPECK  
Saimir SHEHU

Dibër 28.10.2025